



AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË AKSIONARE

" KF POGRADEC " SH.A

Sot, më datë 26/07/2011, përpara meje TH BICJA, noter pranë Dhomës së Noterisë Korçe, me seli në Pogradec, u paraqit me cilësinë e aksionarit themelues:

*Bashkia Pogradec, e përfaqësuar sipas Vendimit të Këshillit Bashkiake, nr. 22 të datës 21/07/2011 nga Kryetari i saj Z. Artan Shkëmbi, shtetas shqiptar, i datëlindjes 12.07.1964, lindur në Pogradec dhe banues në Pogradec, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 027878044,*

i cili ka vendosur krijimin e shoqërisë "KF POGRADEC" Sh.a me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Të themelojë Shoqërinë Tregtare "KF POGRADEC" sh.a, në formën e një Shoqërie Aksionare me oferte private. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë Shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "KF POGRADEC" sh.a, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

**NENI 2**

**Qëllimi i krijimit të Shoqërisë**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit sportiv futboll, rritja e vlerave sportive për sportin e futbollit, duke zbuluar elementë të talentuar dhe përgatitja e tyre për të ardhmen e sportit në përgjithësi. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3**

**Emri, logo dhe vula e Shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin "KF POGRADEC" sh.a.  
Ajo do të ketë logon dhe vulën e saj.

**NENI 4**

**Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:  
Organizimi i aktiviteteve sportive të futbollit.  
Krijimi i ekipeve zinxhir dhe pjesëmarrja në garat sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit.  
Aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare të Futbollit, dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit kombëtare dhe ndërkombëtare.  
Futja në tregun e lojtarëve për të blerë lojtarë sipas nevojave të ekipit.  
Aktivitete të tjera në fushën e futbollit për interesat e shoqërisë dhe Bashkisë.  
Shoqëria, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj.

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj pas marrjes dhe në përputhje me licencat apo lejet përkatëse.

**NENI 5**

**Selia e Shoqërisë dhe afati i veprimtarisë**

Selia e Shoqërisë do të jetë në Pogradec.  
Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**NENI 6**

**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 2.000.000 ( dy milion ) lekë.  
Ai është i ndarë, në 200 aksione të së njëjtës kategori me vlerë nominale prej 10.000 lekë, për çdo aksion të shlyer për tërësinë e vlerës nominale të tyre. Aksionet janë të numërtuara nga 1 deri 200 aksione.  
Aksionarët themelues të Shoqërisë Tregtare " KF POGRADEC" sh.a zotërojnë aksionet në këtë Shoqëri si më poshtë:  
Bashkia Pogradec, zotëron 100% të vlerës së aksioneve në kapitalin themeltar të Shoqërisë të barabartë me 200 numër aksionesh, me vlerë 10.000 lekë secili.

**NENI 7**

**Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para dhe/ose në natyrë i aksionarëve themelues të kësaj Shoqërie.  
Kontributi në para do të jetë i përbërë nga shuma prej 2.000.000 ( dy milion ) lekë, që është edhe vlera minimale e kapitalit themeltar për shoqëritë me oferte private.  
Kapitali i Shoqërisë është depozituar në Bankën "Societate Generale Albania" me seli në Tiranë, filjali Pogradec në llogarinë "Shoqëri në Formim e Sipër" dhe në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate themelimi. Pas regjistrimit, kjo shumë do të kalojë në llogarinë e kësaj shoqërie që do të çelet pranë bankës "Societate Generale Albania". Në llogarinë e shoqërisë çelet llogaria "Fondi themeltar i aksionarëve", ku regjistrohet vlera e kapitalit të tyre.

**NENI 8**

**Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:  
Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve – organi më i lartë vendimarrës;  
Këshilli Mbikqyrës – organ i mbikqyrjes;  
Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

**NENI 9**

**Këshilli Mbikqyrës**

Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë përbëhet nga 3 anëtarë, të cilët janë caktuar si më poshtë:  
Z Stefan Hila, shtetas shqiptar, i datëlindjes 20/04/1968, lindur në Pogradec person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 028618003;  
Znj. Vilma Topçiu shtetas shqiptar, i datëlindjes 14/09/1982, lindur në Pogradec, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 026194322;  
Z. Ilia Gusho, shtetas shqiptar, i datëlindjes 05/09/1970, lindur në Pogradec, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 028335607;

Kohëzgjatja e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës do të jetë tre vjet. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen.

**NENI 10**

**Administratori**

Shoqëria administrohet nga Administratori i cili zgjidhet për një afat 3 vjeçar.

Administratori i i Shoqërisë "KF Pogradeci" sh.a është Z. Nesti Binishi, shtetas shqiptar, i datëlindjes 20/04/1972, lindur në Pogradec dhe banues në Pogradec, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 028686223.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i saj Z. Nesti Binishi, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

**NENI 11**

Organizimi dhe funksionimi i Shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

**NENI 12**

Aksionari themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, përveçse atij që mund të jetë konkruues me atë të shoqërisë "KF POGRADEC" sh.a.

**NENI 13**

Akti i themelimit pasi u gjet sipas vullnetit të përfaqësuesit të aksionarit themelues dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ana e tij para noterit të vendit të themelimit të Shoqërisë. Ky Akt Themelimi hartohet në katër kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

**AKSIONARI I SHOQËRISË**

**BASHKIA POGRADEC**

e përfaqësuar nga

**Z. ARTAN SHKËMBI**

**NOTER**

ZHOMA BICJA

